



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.sh.II.nr.1037/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit S&R Product shpk me seli në fshatin Babush Komuna e Ferizajit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati A.S. nga Ferizaj, kundër të paditurës Pro Credit Bank SHA me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e avokatëve Kërveshi&Partners me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit III.EK.nr.358/16 datës 20.06.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurës Pro Credit Bank SHA me seli në Prishtinë, PRISHET Aktgjykimi III.EK.nr.358/16 i datës 20.06.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike, dhe Lënda kthehet në Gjykatën Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, në rigjykim dhe rivendosje

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, III.EK.nr.358/16 i datës 20.06.2018, në dispozitivin e aktgjykimit ka vendosur: Aprovohet në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S&R Product shpk me seli në fshatin Babush Komuna e Ferizajit, I. Detyrohet e paditura Pro Credit Bank SHA me seli në Prishtinë, që paditësit t,ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit, shumën e përgjithshme prej 10,390.00€, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga paraqitja e padis datë 02.09.2015 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin partitiv prej 7 ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim II Detyrohet e paditura që paditësit t,ia kompensoi edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,403.55€, në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur, Shoqëria e avokatëve Kërveshi&Partners me seli në Prishtinë, e cila e kundërshton aktgjykimin e atakuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozimin që ankesa të aprovohet, të prishet aktgjykimi III.EK.nr.358/16 i datës 20.06.2018, dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.

Në përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit i kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon gjykatës, që ta refuzoj ankesën e palës së paditur si të pabazuar dhe ta vërtetoj Aktgjykimin III.EK.nr.358/16 i datës 20.06.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike,

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, e pas vlerësimit të tyre, në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi S&R Product shpk me seli në fshatin Babush Komuna e Ferizajit, me datën 02.09.2015 ka parashtruar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, padi, kundër të paditurës Pro Credit Bank SHA me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura t,ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit shumë prej 10.390.00€, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padis e deri në pagesën definitive, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Ndër tjerash në padi dhe në seancat gjyqësore i autorizuari i paditësit pretendon se me datën 21.05.2015 ishte hakuar llogaria bankare e paditësit, jashtë territorit të Kosovës nëpërmes bankës irlandeze AIB Bank në Irland nga personi Virian Constantin ish-in tërhequr marr hakuar shuma prej 10,390.00€ përmes transferit ndërkombëtar dalës. Paditësi i ka kryer të gjitha obligimet ndaj bankës, andaj kërkon që kërkesëpadia e tij të aprovohet në tërsi si e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, dhe mbajtjes së seancës gjyqësore me datë 08.06.2018 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit theksohet se me rastin e tërheqjes drejtpërdrejt te mjeteve në llogarinë bankare të paditësit, këtu sistemi mbrojtës bankar ka dështuar dhe ka lejuar ndërhyrjen ilegale në xhirollogari. Banka mban përgjegjësin për transfer të paligjshëm kompjuterik në rastin konkret, klientët e bankës për këtë arsye edhe deponojnë mjetet në bankë, paguajnë mirëmbajtjen e llogaris, në mënyrë që mjetet e tyre të jenë të siguruara nga çdo ndërhyrje e paligjshme. Në ekspertizën financiare datës 26.02.2018 është konstatuar se me datën 21.05.2015 është bërë transferi bankar në shumë prej 10,390.00€ në llogari te Virlan Constantin përmes AIB Bank. Andaj meqë është vërtetuar se e paditura është përgjegjëse për ruajtjen e sigurt të mjeteve që ka në posedim nga klientët, në bazë të nenit 728 paragrafi 1 i LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, sipas detyrës zyrtare, e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 të LPK-së, dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së dytë, ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika (n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërtënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe dokumenteve të administruara si prova.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, ka vlerësuar se arsyetimi i aktgjykimit është i mangët në drejtim të vërtetimit të gjitha fakteve vendimtare që kanë ndikim në vendosjen e kësaj çështje kontestimore. Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme duke ia falur besimin vetëm pretendimeve të padis, dhe ekspertizës financiare, ka marrë aktgjykimin e atakuar, duke e anashkaluar faktin thelbësor për të cilin zhvillohet kontesti. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale.

Aktgjykimi i atakuar në arsyetimin e tij nuk thekson fare se nga cilat prova cilat fakte janë vërtetuar, se e paditura nuk ka ndërmarr asnjë veprim në sigurimin e llogaris bankare të paditësit, apo në çfarëdo shtate tjetër, e paditura është përgjegjëse nga një ndërhyje në llogarin personale të paditësit. Nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë, janë të mangëta provat që vërtetojnë se kemi të bëjmë me një ndërhyrje të drejtpërdrejt nga personat e tretë, përderisa gjykata nuk ka shqyrtuar fare shkresat e lëndës që dëshmojnë se janë ndërmarr një sërë veprimesh nga organet kompetente hetimore, dhe shkresa-përgjigje e datës 25.08.2015 nga subjekti Kujtesa Net, në drejtim të ndriçimit të rastit konkret.

Dhoma e Shkallës së Dytë, nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë, tani për tani nuk mund të pajtohet që në këtë rast gjen mbështetje dispozita e nenit 728 paragrafi 1,2 i LMD-së, për ta bërë përgjegjëse të paditurën për mos ruajtjen e sigurt të mjeteve në posedim nga klientët, sepse nuk kemi një ekspertizë profesionale në lëmin përkatëse (kibernetike) për të vërtetuar ndodhjen e sulmit nga personat e tretë, pastaj fakti se në xhirrollogarinë personale bankare mund të ketë qasje vetëm personi autorizuar, që posedon kodin e gjeneruar të bankës.

Duke u nisur nga kjo gjende e tillë e çështjes, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, ka gjetur se nuk mund të pranohet konkludim juridik i gjykatës së shkallës së parë, si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për shkak të mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale, prandaj është dashur që aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda ti kthehet Dhomës së shkallës së parë në rigjykim.

Në ri-procedurë, Dhomat e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kruciale dhe sipas nevojës përmes nxjerrjes së ekspertizës nga lëmia përkatëse të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ta vërtetojë përgjegjësin apo jo të detyrimit të ndërsjellë të palëve, dhe pas kësaj nëse konstaton se ndonjëra palë ka pësuar dëm, ta vlerësojë dëmin real dhe të marrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.sh.II.nr.1037/23 datë 17.11.2023

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha